



Primar / Dotezua Punëno / Prilato Received / Delivery	07-11-2022	2	viti god year
Organ / Njesia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	6772/2022		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.781/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga:** Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.781/2022 të datës 08.09.2022, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, kundër organit të punësimit/Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike "*shkelje e të drejtës në pagë*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 04.11.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.781/2022 e datës 08.09.2022 e parashtruar nga ankuesi**
- II. **Obligohet Kryetari i Komunës së Lipjanit që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil \_\_\_\_\_ nga koeficienti shtatë (7) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).**
- III. **Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

### A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Komunën e Lipjanit sipas Akt emërimit të datës 14.09.2017 në pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale", në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, me datë 16.06.2022 ka parashtruar kërkesë tek Zyra e Burimeve Njerëzore

në Komunë të Lipjanit, me pretendimet për harmonizim të koeficientit me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës.

Ankuesi i pakënaqur me mospergjigjen në kërkesën e tij nga Zyra e Burimeve Njerëzore, përmes postës me datë 06.09.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 08.09.2022 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.781/2022 me numër protokollit 5216/2022, me pretendimet për harmonizim të koeficientit me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës respektivisht nga koeficienti shtatë (7) me koeficientet me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës që janë nivel drejtues si dhe kërkon që të behet kompensimi material në mënyrë retroaktive nga dita e ushtrimit të detyrës në Komunën Lipjanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa Këshilli, me datë 29.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë përmes formes elektronike (e-mailit zyrtar), së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.10.2022 ka nxjerrë Vendim me numër VK.130/2022 për zgjatjen e afatit për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune, për ankesën me numër A.nr.781/2022 të datës 08.09.2022 sepse me datë 20.10.2022 ka kërkuar prova shtese nga Komuna e Lipjanit.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesë me numër të protokollit 5216/2022 të datës 06.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, përmes postes së kosoves me vulën postare në ploko/zart me datë 06.09.2022; Kërkesë për ngritje të koeficientit e datës 16.06.2022 drejtuar tek Zyra e Burimeve Njerëzore në Komunë të Lipjanit; Akt Emërimi i datës 14.09.2017 pozita: Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale; Listë e pagave për ankuesin për muajin korrik 2022; Përgjigje në kërkesën e KPMSHCK-së e datës 22.09.2022 nga Menaxheri i Personelit në Komunë të Lipjanit, për ankuesin; Përshkrimi i detyrave të punës i nënshkruar (pa datë); Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë i datës 25.01.2021, për vitin 2020 dhe Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë i datës 18.01.2022, për vitin 2021; Provat shtesë përmes E-mail të datës 21.10.2022, Akt emërimi i datës 06.02.2012; Akt emërimi i datës 10.01.2017; Akt emërimi i datës 28.03.2014; Akt emërimi i datës 17.01.2012; Akt emërimi i datës 27.08.2013.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 14.09.2017 është i punësuar në pozitën: "Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale", në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, në Komunën e Lipjan me koeficient të pagës shtatë (7). I njëjti me datë 16.06.2022, ka parashtruar kërkesë me numër reference: 01-120/04-31239



tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore për harmonizim (ngritje) të koeficientit nga koeficienti shtatë (7) me koeficientet me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës që janë nivel drejtues. Pasi që nuk ka pranuar përgjigje në kërkesën e tij nga Zyra e Burimeve Njerëzore, me datë 06.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5216/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që komuna është e obliguar që të bëjë harmonizimin e koeficientit nga shtatë (7) në koeficientin të cilët e kanë udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës respektivisht me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës që janë nivel drejtues si dhe kërkon që të behet kompensimi material në mënyrë retroaktive nga dita e ushtrimit të detyrës në Komunën Lipjanit.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave* si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë. Andaj, në vështrim të këtyre dispozitave si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se organi i punësimit respektivisht Komuna e Lipjanit, nuk ka unifikim të pagës për udhëheqësit e sektorëve pasi aplikohen koeficient të ndryshëm lidhur me këto pozita të kategorisë së njëjtë, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale ka konstatuar se Udhëheqësi i Sektorit për Gjeodezi ka koeficient 7.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit Për Kadastër ka koeficient 7.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore ka koeficient 7.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit për Planifikim dhe Urbanizëm ka koeficient 7.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit për Arsimit ka koeficient 7.5 të pagës, ndërsa udhëheqësit e sektorëve të tjerë duke përfshirë edhe ankuesin si *"Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale"*, kanë koeficient 7 të pagës.. Kështu që bazuar në këto fakte dhe konstatime, Kolegji vlerëson se aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe se trajtimi jo i barabartë i të punësuarve të së njëjtës kategori brenda të njëjtit institucioni është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.*

Nisur nga fakti se ankuesi ka qenë i emëruar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.05/2012 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht sipas nenit 14 të kësaj Rregullore pozita udhëheqës i sektorit përcaktohej si pozitë e nivelit drejtues një (1) me grada shtatë (7) të pagës, duke u evidentuar edhe në Katalogun e Vendeve të Punës (i miratuar me datë 05.02.2015 i ndryshuar dhe plotësuar me 21.08.2018), me EZHE/420 dhe gradë 7 të pagës.



Po ashtu bazuar në nenin 34 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 05/2012 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore kanë qenë të detyruar që të bëjnë klasifikimin, harmonizimin dhe standardizimin e pozitive në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimi dhe vendosjes lidhur me këtë çështje, mori parasysh shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 20.11.2014 të lëshuar nga drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/MAP, për Sekretarët e Përgjithshëm, drejtorët e Agjencive Ekzekutive dhe menaxherët e personelit të institucioneve publike përmes së cilës shkresë janë vendosur koeficientet e pozitive përkatëse rrjedhimisht për pozitën udhëheqës i sektorit është vendosur koeficient tetë pikë pesë (8.5).

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe juridike e konstatuar si me lartë, Kolegji vlerësoj se organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Lipjan me rastin e mos harmonizim të koeficientit të pagës së ankuesit ka vepruar edhe kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë*, kështu që Kolegji vlerëson së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit mbi bazën e harmonizimit të koeficientit të pagës me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon që ky harmonizim të bëhet në mënyrë retroaktive nga muaji shtator 2017, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi Akt Emërimin për pozitën: *"Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale"*, me koeficient të pagës shtatë (7) e ka nënshkruar më datë 14.09.2017. Në kohën kur ankuesi e ka Aktin e emërimit ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës andaj mbi këtë bazë Kolegji, vlerëson se ankesa e parashtruar në Këshill lidhur me pretendimin për kompensim e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 14.09.2017 është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: *"...Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës"* si dhe nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*. Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në faktet e lartëcekur gjegjësisht meqenëse ankuesi nga data e nënshkrimit të Aktit të Emërimit të datës 14.09.2017 nuk ka ndër marr ndonjë veprim juridik në kuptim të kompensimit në mënyrë retroaktive të koeficientit të pagës Kolegji ka konsistuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe se pretendimi i ankuesit është në kundërshtim me afatin e përcaktuar ligjor përkatësisht me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerret të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** **Lënda me numër A.nr.781/2022**

**Zyle Millaku Gojnovci**

*Procesmbajtës*

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*

#### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.